



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me datë **15.10.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 287, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve **Sali Berisha, Jamarbër Malltezi, Fatmir Bektashi, Xhimi Begeja, Andia Pustina, Studio Pustina sh.p.k., Shoqëria Homeplan sh.p.k. dhe Shoqëria Kontakt sh.p.k.**”.

2. Në seancën e datës **19.05.2025** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe dërgimin për gjykim trupit gjykues të themelit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, procedimin penal nr. 287, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve:

- **Sali Berisha**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.
- **Jamarbër Malltezi**, akuzuar për kryerjen e veprave “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, kryer në bashkëpunim me shtetasin Sali Berisha, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal, si dhe “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë e 25 i K.Penal, në formën e parashikuar nga gërma “b”, “c”, “ç” dhe “d” të K.Penal.
- **Fatmir Bektashi**, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal dhe “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi i dytë e 25 i K.Penal, në formën e parashikuar nga gërma “b”, “ç” të K.Penal.
- **Xhimi Begeja**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë e 25 i K.Penal, në formën e parashikuar nga gërma “b”, e K.Penal.

- **Andia Pustina**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal, kryer ne bashkepunim, gjate ushtrimit te nje veprimtarie profesionale, në formën e parashikuar nga gërma “b”, “ç”, “dh” të K.Penal,
- **Studio Pustina sh.p.k.**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal, në formën e parashikuar nga gërma “b”, “ç”, “dh” të K.Penal,
- **Shoqëria Homeplan sh.p.k.**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 paragrafi i parë i K.Penal, në formën e parashikuar nga gërma “b”, “ç” të K.Penal,
- **Shoqëria Kontakt sh.p.k.**, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Pastrimit të Produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 paragrafi i pare i K.Penal, në formën e parashikuar nga gërma “b”, të K.Penal.

Tiranë, më datë 19.05.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar